



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1487/3 prot

Elbasan, më 23.06.2025

VENDIM

Nr. 54, datë 23.06.2025


Për

trajtim me burse financiare, përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2024-2025, të studentëve, që vazhdojnë studimet në program të parë studimi në; programet e studimit me karakter profesional, programet studimit bachelor, programet e integruara të studimit.

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM nr. 903, datë 21.12.2016 "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë", i ndryshuar, VKM Nr. 269, datë 29.03.2017 "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit", i ndryshuar, VBA nr 60 datë 31.12.2024 "Për trajtim me burse financiare, përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2024-2025, të studentëve, që vazhdojnë studimet në program të parë studimi, në programet e studimit me karakter profesional, programet studimit bachelor, programet e integruara të studimit", të ndryshuar, Relacionit datë 30.05.2025 "Për trajtim me burse financiare, përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2024-2025, të studentëve, që vazhdojnë studimet në program të parë studimi në; programet e studimit me karakter profesional, programet studimit bachelor, programet e integruara të studimit", paraqitur nga Administratori z. Eljan Hoxha, Bordi i Administrimit.

VENDOSI:

- 1- Përfiton bursë financiare dhe përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit 1 student në vitin e parë me rezultate pasi është saktësuar statusi pas komunikimit me njësinë bazë, sipas listës bashkëlidhur
- 2- Përfitojnë Bursë financiare 7 studentë me kriterë të tjera, mbas konfirmimit të statusit të tyre, nga të cilët 6 studentë sipas konfirmimeve pas vendimmarrjeve të mëparshme, ndërsa 1 student është rikonfirmuar nga institucioni përkatës, sipas listës bashkëlidhur
- 3- Përfitojnë përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit 10 studentë me kriterë të tjera, mbas konfirmimit të statusit të tyre, nga të cilët 9 studentë sipas konfirmimeve pas



- vendimmarrjeve të mëparshme, 1 student është rikonfirmuar nga institucioni përkatës, dhe, sipas listës bashkëlidhur
- 4- Nuk përfitojnë bursë financiare dhe përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit 4 studentë me kritere të tjera, të cilët nuk plotësojnë kriterin për të cilin kanë aplikuar, sipas listës bashkëlidhur.
 - 5- Për rastet që mund të evidentohen ndryshime në statusin e tyre apo të mosplotësimit të kriterëve të studentëve sipas listës në pikën 1, 2 dhe 3, të mos zbatohet vendimarrja e përfitimit, ndërsa ndryshimet në rastet e përfitimit të listës së pikës 4 të paraqiten për vendimarrje në BA.
 - 6- Të evidentohen nga komisioni rastet e studentëve me status të pandryshuar; jetimë, i verbër, tetraplegjikë, paraplegjikë, fëmijë i policit të vrarë, romë egjiptian, të cilët kanë studiuar në ciklin e parë në UE dhe kanë përfituar bursë apo përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit, por nuk kanë paraqitur kërkesë deri në periudhën që shqyrtohet, si dhe rastet e paevidentuara të studentëve me rezultate (mesatare 9-10-të) dhe të relatohen në Bordin e Administrimit për përfitim bursë apo përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit
 - 7- Vendimarrja të zbatohet pas konfirmimit të statusit të studentëve.
 - 8- Ngarkohet Administratori i Universitetit me zbatimin e këtij vendimi
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BORDIT
Dr. Ardian Durrmishi

